



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës : KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: **Trupi Gjykues II**

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 1 prill 2025

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Ndryshimin e Listës së Provave Materiale
dhe Pranimin e Materialeve si Prova**

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Luka Mishetiç

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Rodni Dikson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykses"), në bazë të neneve 21 dhe 40 të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 102(1)(b), 118(2) dhe 137-138 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 28 nëntor 2024, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") paraqiti për pranim pjesë të vëllimit 1 të studimit *Liridon Kosova*¹ ("studimi"),² që ia tregoi W04401-shit gjatë marrjes së tij në pyetje.³
2. Më 4 dhjetor 2024, Trupi Gjykses nuk pranoi vëllimin 1 të studimit, pa përjashtuar mundësinë e paraqitjes së një kërkesë tjetër në lidhje me të, dhe konstatoi se pjesët e studimit të përdorura me dëshmitarin ishin relevante, por se nuk kishte tregues të mjaftueshëm të autenticitetit *prima facie* të studimit.⁴
3. Më 13 janar 2025, ZPS-ja i kërkoi Trupit Gjykses ndryshimin e Listës së Provave Materiale⁵ për të përfshirë: (i) intervistën e Emrush Xhemajlit me median (përkatësisht, "z. Xhemajli" dhe "intervista e Xhemajlit");⁶ dhe (ii) ballinat e tre vëllimeve të tjera të studimit⁷ ("ballinat"; bashkërisht, "shtesat e kërkuara")

¹ P01879 MNA (0189-1161-0189-1309_extracts_P01879). Fragmentet janë: (i) P01879.1_ET MNA (0189-1161-0189-1163-ET); (ii) P01879.2_ET MNA (0189-1172-0189-1197-ET); (iii) P01879.3_ET MNA (0189-1212-0189-1224-ET); (iv) P01879.4_ET MNA (0189-1235-0189-1247-ET); (v) P01879.5_ET MNA (0189-1251-0189-1256-ET); (vi) P01879.6_ET MNA (0189-1260-0189-1261-ET); dhe (vii) P01879.7_ET MNA (0189-1286-0189-1287-ET).

² Transkripti i seancës, 28 nëntor 2024, f. 23011-23012.

³ Transkripti i seancës, 28 nëntor 2024, f. 23003-23011.

⁴ Transkripti i seancës, 4 dhjetor 2024, f. 23298-23299.

⁵ F03047, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrim prej Prokurorisë i Listës së Ndryshuar të Provave Materiale*, 21 mars 2025, me Shtojcën 1 ("Lista e Provave Materiale"), konfidenciale.

⁶ SPOE00361031-SPOE00361044 (të dyja versionet, në anglishte dhe shqipe). *Shih* Kërkesën, para. 1, poshtëshënimi 4.

⁷ 0189-1611-0189-1613-ET; 0189-1863-0189-1865-ET; 0189-2127-0189-2129-ET. *Shih* Kërkesën, para. 1, poshtëshënimi 4.

(“Kërkesa”).⁸ Gjithashtu, ZPS-ja kërkoi pranimin si prova të shtesave të kërkuara bashkë me pjesët e vëllimit 1 të studimit që ia kishte treguar W04401-shit gjatë marrjes së tij në pyetje (bashkërisht, “materialet e paraqitura për pranim”).⁹

4. Më 24 janar 2025, Mbrojtja e Kadri Veselit (“Mbrojtja”) dorëzoi përgjigje ndaj Kërkesës (“Përgjigja”).¹⁰

5. Më 24 janar 2025, ZPS-ja dorëzoi kundërpërgjigje ndaj Përgjigjes (“Kundërpërgjigja”).¹¹

II. PARASHTRIMET

6. ZPS-ja parashtron se Kërkesa është bërë në kohë pasi të gjitha shtesat e kërkuara burojnë drejtpërdrejt nga marrja në pyetje e W04401-shit, i cili përfundoi dëshminë para pushimit dimëror të Gjykatës.¹² Sipas ZPS-së, vlera provuese e shtesave të kërkuara ndryshoi ndjeshëm gjatë marrjes në pyetje të W04401-shit, që paraqet arsye të vlefshme për të kërkuar përfshirjen e tyre në Listën e Provave Materiale.¹³ Më tej, ZPS-ja parashtron se ekzistojnë arsye të vlefshme për Kërkesën, sepse: (i) intervista e Xhemajlit përforcon autenticitetin *prima facie* të vëllimit 1 të studimit, ku tregohet se është ‘vëllimi 1’ i një vepre më të madhe dhe përmban një betim në hyrje;¹⁴ dhe (ii) ballinat tregojnë se vëllimi 1 i studimit është pjesë e një studimi prej katër vëllimesh dhe është dokument autentik.¹⁵ Në fund, ZPS-ja parashtron se materialet e paraqitura për pranim përmbushin standardin e

⁸ F02827, Prokurorja e Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë për Ndryshimin e Listës së Provave Materiale dhe Pranimin e Materialeve si Prova*, 13 janar 2025, para. 1, 16.

⁹ Kërkesa, para. 2, 16.

¹⁰ F02857, Mbrojtja, *Përgjigje e Mbrojtjes së Veselit ndaj Kërkesës së Prokurorisë për Ndryshimin e Listës së Provave Materiale dhe Pranimin e Materialeve si Prova (F02827)*, 24 janar 2025.

¹¹ F02862, Prokurorja e Specializuar, *Kundërpërgjigje e Prokurorisë ndaj Parashtrimit F02857*, 24 janar 2025.

¹² Kërkesa, para. 6.

¹³ Kërkesa, para. 6.

¹⁴ Kërkesa, para. 7.

¹⁵ Kërkesa, para. 8.

pranueshmërisë pasi janë relevante, *prima facie* autentike dhe kanë vlerë provuese që nuk zhbëhet nga efekti dëmtues i tyre.¹⁶

7. Lidhur me shtesat e kërkuara, Mbrojtja argumenton si vijon: (i) ZPS-ja nuk ka demonstruar se ka dhënë njoftim në kohë apo arsye të vlefshme për të përligjur përfshirjen me vonesë të tyre;¹⁷ (ii) asnjëri nga dëshmitarët të cilëve iu tregua studimi gjatë intervistave me ZPS-në, nuk e njohën materialin e as dhanë dëshmi që do të ndihmonte për konfirmimin e autenticitetit të tij;¹⁸ (iii) meqenëse ZPS-ja ia nxori Mbrojtjes intervistën e Xhemajlit sipas rregullës 102(3) më 15 nëntor 2024, para dëshmisë së W04401-shit, nuk mund të thuhet se nevoja për t'u mbështetur në këtë dokument lindi vetëm pas marrjes në pyetje të W04401-shit;¹⁹ (iv) intervista e Xhemajlit është e vitit 2017 dhe mund të ishte përfshirë në Listën e Provave Materiale shumë më herët;²⁰ dhe (v) meqë vëllime të ndryshme të studimit iu nxorën Mbrojtjes në vitet 2021 dhe 2022, mospërfshirja e këtyre faqeve në Listën e Provave Materiale ishte gabim i ZPS-së.²¹ Më tej, lidhur me pranueshmërinë e materialeve të paraqitura për pranim, Mbrojtja argumenton se: (i) autori i intervistës së Xhemajlit dhe burimi i informacionit janë të panjohur, të pabazuar dhe nuk mund të thuhet se janë të besueshëm;²² (ii) ZPS-ja e intervistoi z. Xhemajli në vitin 2020 dhe nuk e pyeti për intervistën e tij, e as për studimin;²³ (iii) nuk mund të thuhet me siguri se dokumenti që përmendet në intervistën e Xhemajlit është në fakt i njëjti studim i paraqitur nga ZPS-ja për pranim;²⁴ (iv) intervista e Xhemajlit iu bë e ditur Trupit Gjykses që para vendimit për mospranimin si provë të pjesëve të vëllimit 1 të studimit;²⁵ (v) studimit i mungon autenticiteti pasi

¹⁶ Kërkesa, para. 9-15.

¹⁷ Përgjigja, para. 8. *Shih gjithashtu* Përgjigjen, para. 9.

¹⁸ Përgjigja, para. 10.

¹⁹ Përgjigja, para. 11.

²⁰ Përgjigja, para. 12.

²¹ Përgjigja, para. 13. *Shih gjithashtu* Përgjigjen, para. 14.

²² Përgjigja, para. 17.

²³ Përgjigja, para. 18.

²⁴ Përgjigja, para. 19.

²⁵ Përgjigja, para. 20.

pretendohet të jetë hartuar në vitin 1993, por përshkruan një ngjarje që ka ndodhur në shkurt 1995;²⁶ (vi) W04583, një prej themeluesve të Lëvizjes Popullore të Kosovës ("LPK"), i tha ZPS-së se nuk e kishte parë kurrë më parë studimin, dhe W04749, një anëtar i hershëm i LPK-së, tha se studimi nuk ishte dokument i miratuar nga LPK-ja;²⁷ dhe (vii) ZPS-ja nuk ka paraqitur prova shtesë që do të përforconin autenticitetin e studimit për të përmbushur standardin *prima facie*.²⁸

8. Në Kundërpërgjigjen e vet, ZPS-ja parashtron argumentet e mëposhtme: (i) përgjigjja e Mbrotjtjes u dorëzua jashtë afatit dhe duhet të rrëzohet *in limine*;²⁹ (ii) mjeti juridik që kërkon ZPS-ja ishte rezultat i marrjes në pyetje të W04401-shit, konkretisht vendimit të Trupit Gjykses se, për të pranuar vëllimin 1 të studimit, nevojiteshin tregues të mëtejshëm të autenticitetit; (iii) faqja e parë e intervistës së Xhemajlit dhe përmbajtja e saj e bëjnë të qartë se fjalët në të janë të z. Xhemajli; (iv) materiali përmend titullin e studimit; (v) mospërputhja e pretenduar e datës nuk ndryshon asgjë lidhur me argumentin e mëparshëm të ZPS-së se vëllimi 1 i studimit është një dokument i LPK-së që daton para periudhës kohore që mbulon Aktakuza; dhe (vi) çdo shqyrtim i deklaratave të dëshmitarëve që pretendohet se janë kundërthënëse (dhe që nuk janë të pranuar si prova) tejkalon verifikimin e pranueshmërisë *prima facie*.³⁰

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

9. Në bazë të rregullës 118(2), pasi merr njoftim në kohë dhe i tregohen arsye të vlefshme, Trupi Gjykses mund të lejojë ndryshimin e listave të dëshmitarëve dhe të provave materialeve të dorëzuara sipas rregullës 95(4)(b) dhe (c). Me avancimin e gjykimit, çdo kërkesë tjetër për ndryshimin e Listës së Provave Materiale do të

²⁶ Përgjigjja, para. 22.

²⁷ Përgjigjja, para. 23.

²⁸ Përgjigjja, para. 24.

²⁹ Kundërpërgjigjja, para. 2.

³⁰ Kundërpërgjigjja, para. 3.

shqyrtohet edhe më rigorozisht.³¹ Sikurse është theksuar më herët, Trupi Gjykses duhet të bindet se materiali i propozuar ka relevancë dhe rëndësi të mjaftueshme *prima facie* për të përligjur përfshirjen me vonesë të tij dhe se Mbrojtjes nuk i shkaktohet asnjë dëm.³² Në fund, Trupi Gjykses bën vlerësimin duke pasur parasysh fazën aktuale të procesit dhe faktin se Lista e Provave Materiale është, sipas çdo standardi, mjaft voluminoze.³³

10. Dispozitat ligjore përkatëse për pranimin e provave përcaktohen posaçërisht në nenin 40(6)(h) dhe rregullën 138(1) dhe janë shtjelluar gjerësisht në vendimet e mëparshme të Trupit Gjykses.³⁴ Trupi Gjykses do të zbatojë të njëjtat standarde edhe në këtë vendim.

IV. DISKUTIM

A. DORËZIMI ME VONESË I PËRGJIGJES

11. Fillimisht, Trupi Gjykses vëren se Kërkesa është dorëzuar më 13 janar 2025. Përgjigjja është dorëzuar më 24 janar 2025, që do të thotë pas përfundimit të afatit 10-ditor të përcaktuar në rregullën 76. Trupi Gjykses është i mendimit se Mbrojtja nuk ka treguar arsye të vlefshme për dorëzimin e Përgjigjes jashtë afatit.

³¹ *Shih, ndër shumë të tjera*, F01995, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Ndryshimin e Listës së Provave Materiale* ("Vendimi i 8 dhjetorit 2023"), 8 dhjetor 2023, konfidencial, para. 9 (versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjtën ditë, F01995/RED); F02167, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Ndryshimin e Listës së Provave Materiale* (F02099) ("Vendimi i 7 marsit 2024"), 7 mars 2024, konfidencial, para. 10 (versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjtën ditë, F02167/RED); F02501, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Ndryshimin e Listës së Provave Materiale* (F02279) dhe *mbi Mocionin e Mbrojtjes së Thaçit për Përfshirjen e Materialeve in Limine* ("Vendimi i 22 gushtit 2024"), 22 gusht 2024, konfidencial, para. 23.

³² F01656, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Shtimin e Komunikimeve të Përgjuara në Listën e Provave Materiale*, 7 korrik 2023, konfidencial, para. 11 (versioni i redaktuar publik u lëshua më 14 nëntor 2023, F01656/RED); F01785, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Ndryshimin e Listës së Provave Materiale*, 12 shtator 2023, konfidencial, para. 15-17 (versioni i redaktuar publik u lëshua më 10 nëntor 2023, F01785/RED). *Shih gjithashtu* Vendimin e 8 dhjetorit 2023, para. 9.

³³ Vendimi i 7 marsit 2024, para. 10; Vendimi i 22 gushtit 2024, para. 23.

³⁴ *Shih, p.sh.*, F01409, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë të Specializuar për Pranimin e Provave Jogojore*, 31 mars 2023, konfidencial, para. 8-13.

Megjithatë, Trupi Gjykses do të ushtrojë kompetencën diskrecionale dhe do t'i shqyrtojë argumentet e Mbrojtjes të paraqitura në Përgjigje.

B. NDRYSHIMI I LISTËS SË PROVAVE MATERIALE

12. Lidhur me dorëzimin në kohë të Kërkesës, Trupi Gjykses vëren argumentin e ZPS-së se shtesat e kërkuara u bënë më të rëndësishme për shkak të vendimit të Trupit Gjykses të 4 dhjetorit 2024,³⁵ në javën e fundit para pushimit dimëror të Gjykatës, për të mos pranuar si provë vëllimin 1 të studimit mbi bazën se nuk është *prima facie* autentik, pa përjashtuar mundësinë e paraqitjes së një kërkesë të re në lidhje të.³⁶ Gjithashtu, Trupi Gjykses vëren se Kërkesa u dorëzua në javën e parë pas pushimit dimëror të Gjykatës. Duke pasur parasysh se në kontekstin e një gjykimi kompleks me shumë të akuzuar, duhet ruajtur një shkallë fleksibiliteti,³⁷ Trupi Gjykses vlerëson se njoftimi i ZPS-së për shtesat e kërkuara është dhënë në kohë.

13. Lidhur me arsyet e vlefshme dhe relevancën dhe rëndësinë e shtesave të kërkuara, Trupi Gjykses vëren se shtesat e kërkuara synojnë të përforcojnë autenticitetin e vëllimit 1 të studimit.³⁸ Trupi Gjykses vëren se intervista e Xhemajlit vë në dukje se LPK-ja bëri një punim studimor prej katër vëllimesh mbi strategjinë dhe taktikat e luftës të titulluar *Liridon Kosova*, që përmbante një betim në fillim të secilit vëllim.³⁹ Trupi Gjykses gjithashtu vëren se ballinat sugjerojnë që vëllimi 1 i studimit është pjesë e një studimi prej katër vëllimesh që përmendet në intervistën e Xhemajlit.⁴⁰ Për mendimin e Trupit Gjykses, ekzistojnë arsye të

³⁵ Transkripti i seancës, 4 dhjetor 2024, f. 23298-23299.

³⁶ Kërkesa, para. 3.

³⁷ Vendimi i 8 dhjetorit 2023, para. 14; F01902, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Ndryshimin e Listës së Provave Materiale (F01858)*, 3 nëntor 2023, para. 7.

³⁸ Kërkesa, para. 7-8.

³⁹ Kërkesa, para. 7.

⁴⁰ Kërkesa, para. 8.

vlefshme për ndryshimin e Listës së Provave Materiale për të përfshirë shtesat e kërkuara, për të përforcuar autenticitetin e vëllimit 1 të studimit.

14. Lidhur me dëmin që mund t'i shkaktohet Mbrojtjes me ndryshimin e Listës së Provave Materiale, Trupi Gjykses konstaton se: (i) intervista e Xhemajlit iu nxor Mbrojtjes sipas rregullës 102(3) më 15 nëntor 2024,⁴¹ dhe përkthimet në serbishte të ballinave iu nxorën Mbrojtjes përkatësisht më 31 gusht 2021,⁴² 25 korrik 2021⁴³ dhe 8 dhjetor 2022⁴⁴; (ii) shtesat e kërkuara janë të shkurtra; dhe (iii) ZPS-ja nuk synon të mbështetet në përmbajtjen e ballinave.⁴⁵ Për rrjedhojë, Trupi Gjykses konstaton se ndryshimi i Listës së Provave Materiale nuk i shkakton dëm Mbrojtjes.

15. Për arsyet sa më lart, Trupi Gjykses i miraton ZPS-së leje për përfshirjen e shtesave të kërkuara në Listën e Provave Materiale. Trupi Gjykses urdhëron ZPS-në të dorëzojë Listën e ndryshuar të Provave Materiale të saj deri të martën, 8 prill 2025.

C. PRANIMI I PROVAVE

1. Shtesat e kërkuara

16. Sa i takon relevancës së shtesave të kërkuara, Trupi Gjykses rikujton konstatimet e tij të mëparshme se shtesat e kërkuara janë relevante duke qenë se synojnë të përforcojnë autenticitetin e vëllimit 1 të studimit.⁴⁶ Në këtë kontekst, Trupi Gjykses rikujton gjithashtu konstatimin se pjesët e vëllimit 1 të studimit që iu treguan W04401-shit gjatë marrjes së tij në pyetje nga ZPS-ja, janë relevante.⁴⁷ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se shtesat e kërkuara janë *prima facie* relevante.

⁴¹ Shih Paketën 1493 të materialeve të nxjerra.

⁴² Shih Paketën 73 të materialeve të nxjerra.

⁴³ Shih Paketën 36 të materialeve të nxjerra.

⁴⁴ Shih Paketën 615 të materialeve të nxjerra.

⁴⁵ Kërkesa, para. 8.

⁴⁶ Shih, më lart, para. 13.

⁴⁷ Transkripti i seancës, 4 dhjetor 2024, f. 23298, rreshtat 18-23.

17. Sa i takon autenticitetit, Trupi Gjykses vëren se: (i) intervista e Xhemajlit ka datë dhe burim të identifikuar, i referohet drejtpërdrejt studimit që gjithashtu është paraqitur për pranim si provë, dhe përmban informacion që përkon me pjesët relevante të studimit;⁴⁸ dhe se (ii) ballinat kanë datë, tregojnë vendin e lëshimit, janë të shënuara qartë si dokumente të LPK-së, dhe konfirmojnë njëra-tjetrën. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se shtesat e kërkuara kanë tregues *prima facie* autenticiteti.

18. Lidhur me argumentin e Mbrojtjes se autori i intervistës së Xhemajlit dhe burimi i informacionit janë të panjohur, të pabazuar dhe nuk mund të thuhet se janë të mbështetshëm,⁴⁹ Trupi Gjykses rikujton se nuk kërkohet vërtetim i prejardhjes apo autorësisë së materialeve të paraqitura për pranim kur vlerësohet autenticiteti dhe mbështetshmëria *prima facie* e tyre sipas rregullës 138(1), pasi vërtetimi ka të bëjë me peshën provuese të materialeve të paraqitura për pranim dhe jo me pranueshmërinë e tyre, e cila do të vlerësohet si duhet nga Trupi Gjykses në fund të gjykimit, duke mbajtur parasysh tërësinë e provave.⁵⁰

19. Pasi ka konstatuar se shtesat e kërkuara janë relevante dhe *prima facie* autentike, Trupi Gjykses është bindur se ato kanë edhe vlerë provuese *prima facie* në lidhje me faktet dhe rrethanat relevante për këtë çështje gjyqësore, sikurse përshkruhet në paragrafin 13 më lart. Trupi Gjykses gjithashtu është bindur se vlera provuese *prima facie* e shtesave të kërkuara nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre ndaj të akuzuarve, duke marrë parasysh se Mbrojtja do të ketë mundësinë të bëjë parashtrime në lidhje me peshën dhe vlerën provuese të këtyre materialeve

⁴⁸ SPOE00361031-SPOE00361044-ET, f. SPOE000361034, SPOE000361043.

⁴⁹ Përgjigja, para. 17.

⁵⁰ F01596, Trupi Gjykses, *Vendimi i Dytë mbi Mocionin e Prokurorit të Specializuar për Pranimin e Provave Jogojore*, 9 qershor 2023, konfidencial dhe *ex parte*, para. 84 (versioni i redaktuar konfidencial u lëshua më të njëjtën ditë, F01596/CONF/RED; përcaktimi *ex parte* i vendimit u hoq më 22 qershor 2023, F01596/CONF; vendimi u riklasifikua si publik më 15 nëntor 2023, F01596).

dhe mund, nëse dëshiron, të kundërshtojë përmbajtjen e tyre përmes paraqitjes së provave, megjithëse nuk ka detyrimin ta bëjë këtë.

20. Lidhur me argumentin e Mbrojtjes se nuk mund të thuhet me siguri se dokumenti që përmendet në intervistën e Xhemajlit është në fakt i njëjti studim që ZPS-ja ka paraqitur për pranim,⁵¹ Trupi Gjykues vëren se intervista e Xhemajlit i referohet konkretisht një veprë prej katër vëllimesh mbi strategjinë e LPK-së, të titulluar *Liridon Kosova*, që përmban një betim në fillim të secilit vëllim.⁵² Studimi mban të njëjtin titull, dhe vëllimi 1 i studimit tregon se është 'vëllimi 1' i një veprë më të madhe dhe gjithashtu përmban një betim në hyrje.⁵³ Rrjedhimisht, mbi bazë *prima facie* dhe për marrjen e vendimit lidhur me pranimin e tij si provë, Trupi Gjykues është bindur se dokumenti i përmendur në intervistën e Xhemajlit është në fakt i njëjti studim që ZPS-ja ka paraqitur për pranim si provë.

21. Lidhur me argumentin e Mbrojtjes se intervista e Xhemajlit iu bë e ditur Trupit Gjykues që para vendimit për mospranimin si provë të vëllimit 1 të studimit,⁵⁴ Trupi Gjykues thekson se nuk shqyrton dokumente për konfirmimin ose në mbështetje të prejardhjes dhe autenticitetit, në qoftë se ato dokumente nuk janë pranuar apo paraqitur për t'u pranuar si prova.⁵⁵ Megjithëse u vu në dijeni të intervistës së Xhemajlit, Trupit Gjykues nuk mori parasysh këtë material kur mori vendimin mbi vëllimin 1 të studimit.⁵⁶

22. Për arsyet më lart, Trupi Gjykues është bindur se shtesat e kërkuara janë të pranueshme sipas rregullës 138(1).

⁵¹ Përgjigjja, para. 19.

⁵² SPOE00361031-SPOE00361044-ET, f. SPOE000361034, SPOE000361043.

⁵³ P01879.1_ET MNA, f. 0189-1161-0189-1163.

⁵⁴ Përgjigjja, para. 20.

⁵⁵ *Shih, p.sh.*, F01603, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Provave sipas Rregullës 155*, 14 qershor 2023, konfidencial, para. 50 (versioni i redaktuar publik u lëshua më 8 shtator 2023, F01603/RED).

⁵⁶ *Shih* Transkriptin e seancës, 28 nëntor 2024, f. 23020, rreshtat 3-4.

2. Vëllimi 1 i studimit

23. Sa i takon relevancës së vëllimit 1 të studimit, Trupi Gjykses rikujton konstatimin e mëparshëm se vëllimi 1 i studimit vlerësohet si relevant.⁵⁷ Gjithashtu, Trupi Gjykses vëren se ZPS-ja synon të mbështetet në vëllimin 1 të studimit pasi pretendohet se ka të bëjë me taktikat e LPK-së lidhur me zbulimin dhe kundërzbulimin, në veçanti: (i) publikimin e faktit se bashkëpunëtorët nuk do të kurseheshin apo mbeteshin të pazbuluar; (ii) përgjegjësinë e organeve të zbulimit për mbledhjen e informacionit për personat e dyshimtë; (iii) hartimin e listave të bashkëpunëtorëve për t'u vënë në shënjestër; (iv) rolin e organeve të zbulimit në spastrimin e bashkëpunëtorëve në zonat e çliruara; dhe (v) autorizimin për vrasjen e bashkëpunëtorëve.⁵⁸ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se vëllimi 1 i studimit është *prima facie* relevant.

24. Sa i takon autenticitetit, Trupi Gjykses vëren se vëllimi 1 i studimit: (i) ka datë; (ii) tregon vendin e lëshimit; dhe (iii) është i shënuar qartë si dokument i LPK-së. Trupi Gjykses gjithashtu vëren se: (i) ballinat tregojnë se vëllimi 1 i studimit është pjesë e një vepre të LPK-së prej katër vëllimesh; (ii) intervista e Xhemajlit i referohet drejtpërdrejt studimit, duke dhënë tregues të mëtëjshëm për origjinën dhe burimin e këtij materiali;⁵⁹ dhe (iii) vëllimi 1 i studimit përmban informacion që përkon me një pjesë të dëshmisë së W04401-shit.⁶⁰ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se vëllimi 1 i studimit ka tregues *prima facie* autenticiteti.

25. Lidhur me argumentin e Mbrojtjes se studimit i mungon autenticiteti pasi pretendohet të jetë hartuar në vitin 1993, por përshkruan një ngjarje që ka ndodhur në shkurt 1995,⁶¹ Trupi Gjykses rikujton se bën vlerësimin e autenticitetit dhe mbështetshmërisë vetëm mbi bazë *prima facie*. Faktorët dhe rrethanat që tejkalojnë

⁵⁷ Transkripti i seancës, 4 dhjetor 2024, f. 23298, rreshtat 18-23.

⁵⁸ Mocioni, para. 10.

⁵⁹ SPOE00361031-SPOE00361044-ET, f. SPOE000361034, SPOE000361043.

⁶⁰ Transkripti i seancës, 28 nëntor 2024, f. 23003-23011.

⁶¹ Përgjigja, para. 22.

këtë standard mund të jenë relevante për vendimin e Trupit Gjykses lidhur me peshën dhe vlerën provuese që do t'u atribuohet atyre provave në fund të çështjes gjyqësore.⁶² E njëjta vlen edhe për argumentin e Mbrojtjes se W04583, një prej themeluesve të LPK-së, i tha ZPS-së se nuk e kishte parë kurrë më parë studimin, dhe W04749, anëtar i hershëm i LPK-së, tha se studimi nuk ishte dokument i miratuar nga LPK-ja.⁶³

26. Pasi ka konstatuar se vëllimi 1 i studimit është relevant dhe *prima facie* autentik, Trupi Gjykses është bindur se ky material ka edhe vlerë provuese *prima facie* në lidhje me faktet dhe rrethanat relevante për këtë çështje gjyqësore, sikurse përshkruhet në paragrafin 23 më lart. Gjithashtu, Trupi Gjykses është bindur se vlera provuese *prima facie* e vëllimit 1 të studimit nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tij ndaj të akuzuarve, duke marrë parasysh se Mbrojtja do të ketë mundësinë të bëjë parashtrime në lidhje me peshën dhe vlerën provuese të këtyre materialeve dhe mund, nëse dëshiron, të kundërshtojë përmbajtjen e tyre përmes paraqitjes së provave, megjithëse nuk ka detyrimin ta bëjë këtë.

27. Për arsyet më lart, Trupi Gjykses është bindur se vëllimi 1 i studimit është i pranueshëm sipas rregullës 138(1).

28. Pasi ka konstatuar se vëllimi 1 i studimit është i pranueshëm, Trupi Gjykses udhëzon Zyrën Administrative ta pasqyrojë statusin e provës P01879 MFI si të pranuar.

⁶² Vendimi F02328, para. 33.

⁶³ Përgjigja, para. 23.

V. VENDIM

29. Për arsyet e sipërpërmendura, Trupi Gjykses:

- a) **MIRATON** Kërkesën;
- b) **I MIRATON** ZPS-së leje për të përfshirë shtesat e kërkuara në Listën e Provave Materiale;
- c) **URDHËRON** ZPS-në të dorëzojë Listën e ndryshuar të Provave Materiale të saj deri **të martën, 8 prill 2025**;
- d) **PRANON** materialet e paraqitura, përfshirë përkthimet e tyre, si prova sipas rregullës 138(1);
- e) **UDHËZON** Zyrën Administrative të pasqyrojë statusin e provës të P01879 MFI si të pranuar;
- f) **URDHËRON** Zyrën Administrative t'u caktojë numër prove materialeve të tjera të pranuar; dhe
- g) **URDHËRON** ZPS-në të dorëzojë kërkesë për ruajtjen e konfidencialitetit të materialeve të pranuar deri të premten, 18 prill 2025. Përgjigjet ndaj kërkesës duhet të dorëzohen deri të premten, 25 prill 2025. Nuk do të pranohen kundërpërgjigje.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E martë, 1 prill 2025

Në Hagë, Holandë.